

FATOS KONGOLI
BOLERO NË VILËN E PLEQVE
ROMAN

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

BOLERO
NË VILËN E PLEQVE

ROMAN

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2009

Botimi i parë: *Shtëpia Botuese Toena*, shkurt 2009
Botimi i dytë: *Shtëpia Botuese Toena*, mars 2009

Botues: Fatmir Toçi
Korrektore letrare: Dorina Talo
Përkujdesja grafike: Lavdie Cenmurati
Kopertina: Irena Toçi

ISBN 978 - 99943 - 1 - 461 - 4

© Autori dhe Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: (4) 22 40 116; 22 58 893

Tel./Fax: (4) 22 40 117

E-mail: toena@toena.com.al

redaksia@toena.com.al

toena@abcom-al.com

Http:// www.toena.com.al

PJESA E PARË

1.

*A*fër mesditës, kryeinfermierja më tha se duhej të paraqitesha te shefi i pavijonit. Vështrimit tim pyetës ajo iu përgjigj me një ngritje të supeve dhe më braktisi në mes të korridorit, me urdhrin që të lija çdo punë, të shkoja atje ku më kërkonin.

Zyra e shefit të pavijonit, njëherazi dhomë vizitash e tij, ndodhej në skajin e kundërt të klinikës, përtej një paretit me dyer xhami mat, në fund të korridorit. Për t'u futur te shefi, duhej të kaloje një paradhomë, ku vigjilonte një bionde me emrin dyrrokësh Eda, afërsisht moshatare me mua: rreth të tridhjetave. Nga personeli kjo njihej me nofkën Sharon Stoun. Nuk e kuptoja pse e mbiqquanin kështu, midis saj dhe vedetës së famshme nuk kishte ndonjë

ngjashmëri. Për këtë arsye, sa herë përballesha me të e shihja vëmendshëm, të gjeja ngjashmërinë. Por më shumë për një arsye jo aq asnjënjëse: më pëlqente ta shihja. Më pëlqente edhe parfumi që çlironte trupi i saj. “Një parfum i shtrenjtë parisian”, thoshin infermieret.

Para derës së mbyllur të studios së shefit gjendeshin nja pesë-gjashtë vetë, burra e gra. Kur iu afrova, ata më hapën rrugë. Trokita me një kureshtje të vakët: ç’punë kishte doktori me mua? Ndërkaq, në kuadratin e derës u shfaq Eda. Më ftoi të futesha brenda dhe, pasi mbylli derën, më tha të zija vend në të vetmen karrige këndeje tryezës së saj.

S’po ndihesha e qetë. Nuk gjeja një motiv për të cilin doktori të më thërriste posaçërisht në dhomën e tij të vizitave. Ai nuk thërriste askënd atje, aq më pak një infermiere të rëndomtë si unë. Ç’është e vërteta, prej kohësh nuk impresionohesha nga asgjë, pra s’do të impresionohesha edhe sikur doktori, në këtë thirrje të papritur, të më komunikonte vendimin më të skajshëm, domethënë se isha e pushuar nga puna. Kjo gjasë përjashtohej. Unë nuk merrja të holla nën dorë nga pacientët, sido që nuk kishte ndodhur të pushohej nga puna ndonjë mjek apo infermiere për një motiv të tillë. Mbaja mend vetëm një rast pushimi, nja tre-katër vjet të shkuara, kur një infermiere u kap duke bërë seks në turnin

e natës me një pacient. Më vonë, me ndërrimin e shefit të pavijonit, - kjo ndodhte sa herë ndërroheshin qeveritë, ose kryheshin ndryshime qeveritare, rrjedhimisht sa herë ndërrohej ministri i Shëndetësisë, - me ardhjen në krye të shefit aktual, ajo u rikthye në detyrë me premtimin se nuk do ta përsëriste më gabimin fatal. Ky gjest i shefit të ri, deri atëherë mjek i thjeshtë i klinikës, u mirëprit nga personeli. Për kompensim, askush s'bëri fjalë kur, pas këtij gjesti, kolegu i ngritur në përgjegjësi, në vend të asistentes së pararendësit, caktoi në paradhomë bionden me emrin dyrrokësh Eda, që e mbiquajtën shumë shpejt Sharon Stoun.

Një copë herë u përpoqa të mos i çoja sytë tek Eda. Në fillim i mbajta përtokë, mbi dysheme. Pastaj i enda mbi mure, ku midis posterave me përmbajtje mjekësore, tërhiqte vëmendjen një kalendar i përmasave të mëdha me poza të miseve të vitit të shkuar. Më lindi një mendim: ta pyesja Edën nëse i pëlqente më shumë Miss Albania, apo Miss Shqipëria. Më tej, po t'i qe dhënë mundësia dikur, në cilin nga këto spektakle do të kishte dashur të merrte pjesë, te Miss Albania apo te Miss Shqipëria?

Pa i bërë ballë tundimit, sytë më shkuan tek Eda. Kjo po mbushte ca formularë. Mbante veshur një bluzë të bardhë, prej cohe të një cilësie më të lartë se bezja e zakonshme e

bluzës sime. Nga pozicioni i prirët ku ndodhesha, përfitova të zhytesha në profilin e saj, me lakoret e buta të ballit, hundës, buzëve të mbyllura. Atje sytë qëndruan për një çast. Pata dëshirë t'i shkoja pranë, t'i prekja buzët, t'ia thithja. E alarmuar se mos ajo e kishte kapur këtë dëshirë timen, ngriva në pritje të ndonjë reagimi. Fjala vjen, të më urdhëronte të zhdukeshja nga paradhoma. Por ajo, indiferente ndaj meje, vazhdoi të merrej e patrazuar me plotësimin e formularëve. I lashë buzët, zbrita poshtë, te lakoret e mjekrës, gushës dhe, edhe më poshtë, atje ku bluza e kopsitur deri sipër lejonte paksa shfaqjen e gufmimit të gjinjve. Dyshova se gjinjtë ishin të lëshuar, pa sutiena. Dyshova gjithashtu se për shkak të vapës, nën përparësen e bardhë, nuk mbante as këmishë. Atëherë kërciti dera e dhomës së doktorit. U drodha dhe automatikisht u gjenda në këmbë.

Doktori, nja dyzet e pesë vjeç, me një bluzë të bardhë prej të njëjtës copë të cilësisë së mirë të asistentes, më tha: “Eja!”. Me zë të ulët, me një lloj komplisiteti, të thuash se po më ftonte për një seancë seksi. Edhe kjo gjasë përjashtoj dhe unë u futa në dhomën e vizitave pak a shumë e qetë, ja ngaqë nuk po më ftonin për një seancë seksi, ja ngaqë kontakti në largësi me buzët e asistentes ishte ndërprerë.

“Kjo është zonjusha Parashqevi, për të cilën sapo folëm”, i tha doktori një burri që po rrinte

në këmbë, mbështetur pas një biblioteke mbushur pjesërisht me libra, pjesërisht me lloj-lloj sendesh. Fakti që doktori më quajti zonjushë, sidomos fakti që deri para pak çastesh ata kishin folur për mua, më hutoi. Burri, një tip i pashëm shtatlartë, rreth të dyzetave, sajoi një buzëqeshje. Me gjithë vapën mbante kostum e kravatë. Kostumi ishte ngjyrë blu dhe i rrinte mjaft mirë. Kravata po blu, me pika rrumbullake të bardha. Më pëlqeu fytyra e tij, prej nga më shihnin me një lloj kureshtjeje dhe mirëkuptimi bashkë ca sy të qetë. “Zotëria quhet Leonard Voga, shkurt e thërrasin Nardi, plotësoi njohjen doktori. Hëpërhë, mëso prej meje se është president i firmës së ndërtimit “Kuartet”. Ke dëgjuar ndonjëherë për firmën “Kuartet”? Është më e fuqishmja në atdheun tonë të dashur.”

S’po merrja vesh asgjë. Unë nuk isha mësuar të trajtohesha me kaq afërsi mashkullore. Aq më pak nga burra si doktori apo tipi i pashëm që, me ç’mësova, i përkiste kategorisë së bosëve. Me një parandjenjë të turbullt, mbeta në mes të dhomës, nën vëzhgimin e dy burrave. Pata një si këputje, më erdhi të ulesha në karrige, ose në shtratin pranë aparatit me të cilin doktori kryente ekot e zemrës, por përderisa askush nuk po më thoshte të ulesha, u përqendrova. “Nuk e di përse mund të jem e dobishme, doktor”, thashë me gjysmë zëri.

Burrrat vështruan njëri-tjetrin. “Mund të jesh shumë e dobishme, ma ktheu doktori, varet nga ti.” Këto fjalë ai i shqiptoi me të njëjtin komplisitet të pak çasteve më parë, kur më kishte ftuar të futesha brenda, të thuash se më ftonte për një seancë seksi. Për shembull, në shtratin pranë aparatit të ekove të zemrës. Në atë shtrat ndodhte që ai t’i bënte ca vizita jo mjekësore asistentes me nofkën Sharon Stoun. Unë vetë nuk shpresoja në mundësinë e ndonjë ftese për vizita të tilla. Megjithatë, fjalët e doktorit, sipas të cilave mund të isha e dobishme dhe, që të isha e dobishme varej prej meje, më ngacmuan. Më çuan të realizoja një arsyetim formal: thirrja ime në dhomën e vizitave të shefit nuk ishte e rastit. Nëse nuk lidhej me shtratin pranë aparatit të ekove, duhej të lidhej me praninë e burrit të pashëm shtatlartë. Duket, mund të isha e dobishme për të. Po ç’nevojë mund të kishte ai njeri për një qenie si unë?

Nja pesëmbëdhjetë minuta më vonë dola nga zyra e shefit me një lloj pështjellimi. E zhytur te formularët, Eda as e mori mundimin të ngrinte kokën. Ndërkaq, e kishte parë me vend të zbërthente kopsën e sipërme të përparësës, çka më dha mundësi të vërtetoja pjesërisht dyshimet e pak çasteve më parë. Nën bluzë, gjinjte e saj ishin të lëshuar, pra nuk mbante sutiena. Këmishë mbante. Sikur asistentja të tregohej pak më e njerëzishme dhe të më

pyeste për motivin e thirrjes te shefi, do t'ia tregoja, mbase do t'i kërkoja edhe ndonjë këshillë. Asistentja nuk shfaqti ndonjë kureshtje dhe unë dola nga dhoma. Në korridor ndesha të njëjtat fytyra që prisnin, dikush u interesua të më pyeste nëse kishte ende njerëz në dhomën e vizitave. Nuk iu përgjigja. Ndihesha e shpërqendruar dhe vajta drejt e në sallën e infermierisë.

Kryeinfermieren e gjeta tërë nerva. Kjo ishte një grua e shëndoshë, në moshën kalimtare. Vartëset e mbiquanin Hipopotam. Për shkak të trupit disproporcional. Fytyrës, ku shquheshin ca sy të zinj, buzë të trasha, me një shtresë të dukshme qimesh. Dhe gjinjve tepër të mëdhenj. “Ku humbe deri tani, m'u hakërrye, nga bredh?” “Hipopotam, më erdhi t'ia ktheja, nuk më the vetë të shkoja te shefi?” Heshta. U prira ta merrja me të mirë. Si merret me të mirë një kafshë e lodhur. Nëse zbutej, t'i tregoja motivin e thirrjes te shefi.

Ajo nuk u zbut. Më tha të nisesha urgjentisht për në laborator dhe po aq urgjentisht të sillja përgjigjet e analizave të mëngjesit. Pa dyshim, duhej të ishte zënë me dikë dhe shkelmat m'i hidhte mua. Zbatova urdhrin, u nisa drejt laboratorit. Atë ditë mbase do të mund të guxoja të mos ia zbatoja urdhrin, kisha një arsye të fortë të ngrija krye, edhe pa qenë nevoja ta shaja me vete “Hipopotam!”. M'u duk e padenjë. Tani, kur megjithëse ia

duroja shkelmat prej më se pesë vjetësh dhe jo rrallë më vinte ta shaja Hipopotam, kuptova se ajo ishte e vetmja në pavijon, së cilës do të kisha pasur dëshirë t'i tregoja motivin e thirrjes te shefi.

Nuk po zgjatem. E përmenda Hipopotamin thjesht sepse me të dalë nga paradhoma e Eda-Sharon Stoun, e përcjellë nga shpërfillja e saj dhe era e parfumit të shtrenjtë parisian, e hasa në infermieri dhe, për shkak të ndonjë grindjeje me dikë, po ndoshta, - këtë e çova ndër mend më pas, - për shkak se duhej të gjendej në ujërat e menopauzës, ajo më priti me këmbët e para dhe mua më erdhi keq për të. E shkreta Hipopotam, më kishte ngjallur gjithmonë mëshirë. Jo vetëm sepse më dukej si një kafshë e lodhur. Tek ajo unë shihja vetveten. Megjithëse s'jam aq trupmadhe, nuk kam as buzë të trasha, as ndonjë shtresë qimesh te buzët apo te këmbët. Kjo nuk ndryshon asgjë. Ashtu si Hipopotami, e fusja veten në kategorinë e femrave të shëmtuara. Këto, kur kanë një lloj pushteti, si Hipopotami, përbuzen, urrehen nga koleget. Kur nuk kanë, si unë, shpërfillen. Si një send që bën pjesë kushedi përse në dekorin e mjedisit. Për koleget e mia, në përgjithësi për këdo që hynte e dilte në pavijon, unë kam qenë gjithmonë një send i dekorit. Një qenie në nivelin zero të zhvillimit mendor. Më urdhëronin të gjithë dhe unë u bindesha të gjithëve. Merrja përsipër edhe

punë që s'më takonin, të cilat i kryeja pa u mërzhitur. Ishte mënyra ime për të mbijetuar, për t'iu përshtatur një bote, ku një femër si unë mbetet jashtë loje.

Atë ditë, pra, mund t'i kisha dhënë vetes të drejtën e një kryengritjeje të vogël. Të mos u bindesha urdhrave të Hipopotamit, të lija çdo punë. T'ia mbathja fare, të largohesha nga pavijoni para mbarimit të orarit zyrtar, pa i dhënë shpjegime askujt. Ndihesha e eksituar. Ose, si thuhet, me një vërshim adrenaline. Dy meshkuj jo si gjithë të tjerët, njëri shefi i pavijonit, tjetri një burrë i pashëm i kategorisë së bosëve, më kishin trajtuar me një afërsi të paprovuar ndonjëherë. Kjo më bëri të realizoja me një lloj hutimi thelbësoren: në sytë e disa njerëzve duket nuk përfaqësoja thjesht një send të papërfillshëm, pavarësisht nëse koleget më quanin me ndonjë nofkë të përshtatshme për një femër të shëmtuar, në shkallën zero të zhvillimit mendor. Asnjëra nga këto konsiderata nuk i pengoi ata dy burra të më ftonin në një konsultë të mbyllur private, të më bënë një propozim. Jo për ndonjë seancë seksi. Por unë u eksitova, në gjak më vërshoi aq shumë adrenalinë, të thuash se ata më ftuan për një seancë seksi.

Pjesën tjetër të ditës e kalova si gjithmonë, duke duruar në heshtje shkelmat e Hipopotamit. Në mungesë të një viktime më komode, kjo vazhdoi të shkarkohej mbi mua

derisa klinika zuri të braktisej nga personeli dhe unë u largova vetëm pasi mbërriti një sanitare e turnit të dytë. Atëherë u ndjeva e këputur. Me një pikëpyetje të madhe brenda vetes: Ç'të bëja?

Ata më kishin hedhur një karrem. Duhej të vendosja, ta kafshoja ose jo. Po të mos e kafshoja, nuk humbisja ndonjë gjë, do të vazhdoja të kryeja në spital ato punë rutinë që i kryeja prej më se pesë vjetësh. Doktorin më sqaroi se puna ime vlerësohej pozitive. Përndryshe nuk do të guxonte të më rekomandonte mua te miku i tij, presidenti i firmës “Kuartet”, si më të përshtatshmen për zgjidhjen e një problemi me rëndësi jetike për të. Fjalët “me rëndësi jetike” doktori i theksoi. Pastaj hodhi karremin. Nëse unë pranoja ofertën, jeta ime, përfshi gjendjen materiale, do të ndryshonte rrënjësisht. Në njëfarë mënyre, do të bëhesha pjesë e familjes së bosit. Për të qenë i qetë me veten, ai më kujtoi proverbin “Mat shtatë herë, prit një herë”.

Ka të ngjarë që bosin, i cili tërë kohën më shihte në heshtje, të ketë nuhatur diçka nga natyra ime dyshimtare. Kur doktori i dha fund parashtrimin të ofertës dhe më kujtoi proverbin “Mat shtatë herë, prit një herë”, ai më hodhi një karrem tjetër. Më ftoi të darkonim bashkë atë mbrëmje, në Sky Towers, në orën tetë. “Do të pres përgjigjen tënde, më tha, sido që të jetë.” Unë nuk e dija se si do të përgjigjesha. Thashë

se në Sky Towrs s'kisha qenë ndonjëherë. Ai më tha se do të më priste poshtë, te shkallët e hyrjes.

Pyetjen përse më zgjodhën pikërisht mua ia bëra vetes kur mbërrita në shtëpi. Banoj në një pallat jo larg spitalit, buzë Unazës, në një apartament dy dhoma e kuzhinë. Vetëm. Kam një motër, më të vogël, nja tre vjet më të vogël, të martuar. Tani ndodhet në Kanada. Ka tre fëmijë, vajzë dhe dy djem. Vajzën e kishte që këtu, djemtë i lindi atje. “Shpëtove”, i thashë kur ikën familjarisht dhe i përcolla në aeroport. Ajo më tha se edhe unë do të shpëtoja. “Patjetër”, iu përgjigja, e sigurt për të kundërtën. E kam ditur gjithmonë, në këtë botë shanset e mia janë të pakta. E kam ditur qysh se kuptova dhe e futa veten në kategorinë e të shëmtuarave. Për këtë u kam mbajtur inat gjithë jetën prindërve. U mbaj inat edhe sot. Kjo ma ngarkon shpirtin rëndë: ata nuk janë më. Rajmonda, - kështu quhet ime motër, - kishte bukurinë, zgjuarsinë dhe emrin tingëllues. Mua, përveçse nuk isha e bukur, nuk më mbanin as për të zgjuar. Po të mos përmend emrin tim demode, si më dukej: Parashqevi! Emri i gjyshes, më thoshin, i gjyshes nga babai. Ç'punë kisha unë me emrin e gjyshes nga babai? I vetmi ngushëllim mbetej fakti se këtë emër e mbante një këngëtare. Por

Parashqevia këngëtare ishte e bukur, kishte zë edhe më të bukur, ishte, si thuhet, një star, e njihnin dhe e donin të gjithë. Ndërsa mua s'më njihte dhe s'ma varte askush.

Në shtëpi zura të mendoja më qetësisht. Në takimin e orës tetë do të shkoja, nuk e vija në diskutim. Po përse më kishin zgjedhur pikërisht mua? Këtë pyetje ia bëra vetes në banjë, nën dush, dhe për një çast u preva. “Teveqe, mendova, si nuk e kupton? Je një qenie në shkallën zero të zhvillimit mendor, ja përse të kanë zgjedhur. Ndryshe, sikur ajo punë të ishte e lakmueshme, nuk do të të vinte radha ty.”

Ky arsytim m'u duk bindës. E para në radhë, fjala vjen, mund të ishte Eda-Sharon Stoun. Një ofertë me leverdi doktori do t'ia ruante asaj, jo mua. Duke arsyetuar kështu, pa vetëdije ngrita kokën nga fluksi i ujit, mbështolla duart rreth gjinjve, mbylla sytë. “Mbase, thashë me vete, shkalla zero e zhvillimit tim mendor në këtë mes nuk hyn. Doktori s'do të pranonte kurrë ta largonte Edën nga paradhoma e studios. Edën ai nuk do t'ia dorëzonte askujt, kundrejt çfarëdo çmimi. Atëherë, përse më zgjodhën mua?”

Edhe sikur doktori, për hir të mikut të tij të pashëm bos, të vendoste të hiqte dorë nga Eda, kjo me siguri nuk do ta pranonte ofertën. Domethënë të mbyllej me dy pleq, të aftë të kryenin vetëm nevojat vetjake. T'u përkushtoj

nga mëngjesi në mbrëmje dhe nga mbrëmja në mëngjes. Përveç detyrave të infermieres, të kryente edhe detyrat e kuzhinieres. T'u lante dhe hekuroste rrobat, t'i nxirrte në shëtitje. Kryesorja, të flinte në të njëjtën shtëpi ku banonin ata. Kjo do të kompensohej me një pagë mujore sa trefishi i rrogës në spital, ma garantuan edhe doktori, edhe bosi. Megjithatë m'u duk e pamundur që Eda të tundohej nga kjo rrethanë. Dhe të braktiste paradhomën e studios së vizitave të shefit të një pavijoni ku, përveç favoreve të njohura, përkëdhelej nga të gjithë me nofkën Sharon Stoun.

Një kandidaturë e mundshme, e vazhdova më tej arsyetimin, do të kishte qenë Hipopotami. Ajo kalonte një periudhë tepër të vështirë. Nuk e kam fjalën për moshën problematike të menopauzës. Ndonjë ditë, thuhej, s'duhej të habiteshim po të merrnim vesh se Hipopotamin e kishin gjetur të varur. Në shtëpi ose gjetiu. Hamendje jo dhe aq jashtë realitetit. Vetëvrasjet e femrave te ne janë të modës. E pohoj thjesht si fakt, pa ndonjë lidhje me të mjerën Hipopotam. Unë nuk besoja që ajo t'u jepte fund ditëve të saj me një nga mënyrat e përhapura të vetëvrasjes së femrave shqiptare, duke pirë bar miu, koçifoz, ndonjë helm tjetër më të fortë, apo thjesht duke u hedhur nga kati i shtatë i pallatit. Para dy vjetësh, atë e kishte braktisur i shoqi. Ai maskara ia punoi pabesisht. Ia mbathi me

dashnoren e vet për në Greqi, në një qytet s'dihej se ku, dhe Hipopotami mbeti vetëm, me dy fëmijët, një djalë nja gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe një vajzë pak më të vogël. Djali, thuhej, ishte i prapë, përdorte dhe drogë. Këtë thashethem unë e merrja me rezervë, përfli tej nga dy infermiere armike të shpallura të Hipopotamit. Sidoqoftë, edhe pse nuk e besoja që Hipopotami një ditë të vendoste t'i mbyllte hesapet me botën, në gjendjen e saj ajo do t'i kishte pranuar pa u menduar gjatë kushtet e ofertës. Domethënë të mbyllej me dy pleq, të aftë të kryenin vetëm nevojat vetjake, t'u shërbente nga mëngjesi në mbrëmje e nga mbrëmja në mëngjes, mjaft që të merrte pagën e premtuar. Pse atëherë doktori dhe bosin më zgjodhën mua dhe jo Hipopotamin?

I dhashë vetes të njëjtën përgjigje. “Hipopotami, mendova, është një kafshë pune tmerrësisht e lodhur, unë një qenie në shkallën zero të zhvillimit mendor. Ata kanë parapëlqyer variantin tim. Mbështetur edhe në një rrethanë tjetër. Hipopotami e ka një familje. Unë jam vetëm, pa askënd veç motrës në Kanada. Por kjo zëre se nuk ekziston. Ata e dinë këtë. Midis një qenieje si unë, mbetur fillikat, dhe Hipopotamit, më kanë zgjedhur mua.”

Dola nga banja e nervozuar nga arsyetimet e mia. Këmbët më çuan në korridor. Atje kam një portmanto të stilit të vjetër, me sirtarë të shumtë dhe pasqyrë vertikale, ku mund të

vështrohem e tëra, nga maja e kokës deri poshtë. Vështrimi në pasqyrë është për mua një torturë. Shpesh marr vendim të mos shihem më nga frika se një ditë do të më hipë t'i thyej pasqyrat e shtëpisë, tri copë gjithsej, një në banjë, një në dhomën e gjumit, e fundit, më e madhja, në korridor. Kjo është një mendjeshkrepje, së cilës nuk ia dal t'i përmbahem. Dua, s'dua, detyrimisht i dorëzohem njërës prej pasqyrave. Me raste, të triave radhazi, për të konstatuar të vërtetën e përhershme: jam një femër e shëmtuar. E bindur në çiltërsinë e pasqyrave, me gjithë yshtjen për t'i thyer, unë nuk e kryej një veprim të tillë. Nuk është faji i tyre që fytyra ime del ashtu si del.

Vajta, pra, drejt pasqyrës së madhe vertikale në korridor. Isha e lagur, flokët më vareshin mbi ballë e supe. Flokët e mi janë të zinj, të trashë, të dendur, kur i laj dhe i kreh, ata derdhen. I mbaja gjithmonë lidhur me kapëse. Do të doja t'i mbuloja fare, nuk më hynin në punë. Me një lëvizje të kotë, mbështolla pelerinën deri në grykë, sikur nga pasqyra po më vështronte dikush, dhe unë nuk desha t'i zbuloja trupin tim lakuriq. Përfytyrova bosin. Mirëpo nga pasqyra nuk më shihte bosin. Më shihte fytyra ime, e mbuluar pjesërisht nga kapuçi i pelerinës. Ajo më përqeshi. Unë hoqa kapuçin, i nxora gjuhën. Ajo nuk më përqeshi më. U bë serioze dhe më lejoi ta shihja.

Ky është kurthi që më gatit gjithmonë fytyra ime: më lejon ta shoh, pastaj egërsohet. Si do të egërsohej, për shembull, Eda-Sharon Stoun, po të ndihej e ngacmuar prej meje. Ndaj Edës unë tregohesha vigjilente. Sillem vigjilente ndaj çdo fytyre femërore që më ngjall dëshira dhe nuk më ka ndodhur të zihem në flagrancë nga ndonjëra prej tyre. Ndërsa fytyra ime serioze më zë në flagrancë. “Je një shëmtirë”, më thotë. Dhe mua më vjen të thyej pasqyrën. Këtë herë, e trembur se unë do ta thyeja vërtet pasqyrën, fytyra ime serioze u tregua e durueshme. Më lejoi ta shihja për një kohë të gjatë, pa ma përplasur turinjve fjalën “shëmtirë”. Kjo më dha zemër. Meqë përballë meje pa pikë dyshimi nuk qëndronte bos, lëshova kindat e pelerinës, e lashë të binte mbi dysheme. Fytyra ime serioze përsëri nuk reagoi. Më lejoi të vështroheshja nga maja e kokës te këmbët. Kreva vetëm një veprim qesharak. Ngrita duart dhe mbulova gjinjtë. Gjinjtë e mi janë të vegjël, aq të vegjël sa më vjen zor t’i shoh. E vetmja pjesë disi tërheqëse e trupit, përmasat e të cilit më fusin në kategorinë e të shkurtrave, janë këmbët. Ose, për saktësi, mund të jenë këmbët. Ime motër, Rajmonda, që kishte gjithçka i duhet një vajze për të qenë e bukur, ankohej shpesh për këmbët e saj, të holla për guston e përgjithshme mashkullore. Në vitin e dytë të shkollës së mesme, ajo zuri të hante si e marrë që të shëndoshej ca, e kështu t’i

mbusheshin këmbët. Vërtet u shëndosh, por këmbët i mbetën po aq të holla. U qetësua disi kur mësoi se duhej të ndihej me fat për këmbët e saj. Çdo vajzë që ëndërronte të bëhej top modele do t'ia kishte zili.

I dhashë fund veprimit tim qesharak. Ula duart dhe u përqendrova te gjinjtë. Vetëm për një çast. Më duhej të merrja një vendim, të ktheja një përgjigje. Këtë nuk mund ta zgjidhja duke vështruar në pasqyrë trupin tim lakuriq. Aq më pak gjinjtë e mi të vegjël. Trupi im lakuriq, veçanërisht gjinjtë e vegjël, më ngjallnin pothuajse neveri. Fytyra ime serioze, e cila po tregohej shumë e duruar dhe ende s'ma kishte përplasur fjalën “shëmtirë”, më këshilloi t'i largohesha pasqyrës. Tek shkoja drejt dhomës së gjumit, më lindi një pyetje parazite: po të shtoja ushqimin, domethënë po të përpiqesha të shëndoshesha, si kishte vepruar ime motër, a mbetej ndonjë shpresë që gjinjtë e mi të vegjël, aq të vegjël sa më vjen zor t'i shoh, të fryheshin sadopak?

Pasqyrës së madhe vertikale të korridorit iu dorëzova përsëri rreth orës gjashtë. Kësaj radhe jo lakuriq. Gjithnjë pa e pasur të qartë se ç'duhej të bëja: ta pranoja ofertën apo ta hidhja poshtë? Ftesa e bosit për t'u takuar, nuk ishte një ftesë për seks. Nuk ishte së paku as ftesë për ndonjë bisedë çfarëdo, pa lidhje me faktin që unë isha një infermiere e rëndomtë, fillikat në këtë botë. Më e përshtatshmja për të

kryer një angari vështirë të pranueshme nga çdo infermiere apo sanitare në kushte normale. Po ndihesha kafshë pune. Kjo më nxiste të ngrija krye, ta hidhja poshtë ofertën. Por fytyra ime serioze më tërhoqi vëmendjen sapo zura vend para pasqyrës. “Mos u trego debile, më këshilloi, në vend të këtyre idiotësive, mendo më mirë se si do të vishesh.”

Këtë po bëja: po vrisja mendjen se si do të vishesha. S’kishte rëndësi motivi i takimit, as se çfarë përgjigje do të jepja. Mjafton të rrija qoftë për disa çaste vetëm për vetëm me atë burrë të pashëm edhe pse, e dija, në sytë e tij isha një kafshë pune. Kjo bënte pjesë në logjikën e sendeve. Ndryshe s’do të ndodhte kurrë të ftoheshja prej tij në një mjedis të zgjedhur, në zonën më shik të kryeqytetit. Me këtë rast vura re, jo aq e befasuar, një fakt: gardëroba ime ishte mediokre. Nuk tregoja kujdes në të veshur, veçanërisht pas ikjes së Mondës. Kur mbeta vetëm, në një apartament tepër të bollshëm për mua, dy dhoma e kuzhinë. Dhe largoja të gjithë meshkujt që më afroheshin, ca tipa të poshtër hileqarë. Synimi i tyre nuk isha unë. Synimi ishte apartamenti im.

Nga shtëpia dola në orën shtatë. Fytyra ime serioze duroi për gati një orë, duke hedhur poshtë njëri pas tjetrit variantet e propozuara prej meje për veshjen e mbrëmjes. Derisa më përplasi turinjve epitelin “shëmtirë”. E

braktisa, dola e veshur në mënyrën më të zakonshme: pantallona xhins, një T-shërt i zi, atlete të bardha. Pa kurrfarë tualeti. Sikur po shkoja në pavijon, turnin e natës. Tashmë në kokën time po merrte formë edhe përgjigjja: “Jo!”. Për inat të fytyrës sime serioze, e cila ma nxinte jetën më shumë se kushdo tjetër. Do të shkoja në takim vetëm për të mos i dalë fjale atij burri të pashëm. T’i thosha “jo” dhe t’ia mbathja. Pastaj të çmendesha duke u grindur me fytyrën time serioze. Ndoshta të thyeja të gjitha pasqyrat e shtëpisë, që të mos e shihja më.

Punët nuk vajtën kështu. Rrjedhimisht, nuk theva asnjërën nga pasqyrat.

M’u desh të sorollatesha në trotuarin me palma, përbri Kazinosë tërë drita në Parkun Rinia, në pritje të kalonin minutat dhe akrepat të shënonin orën tetë. Atëherë, midis një turme plot gjinj të zbuluar vajzash, kapërceva urën e ngushtë të Lanës, që bëhej edhe më e ngushtë për shkak se një lypës ishte pozicionuar në mes të saj. Një lypës i veçantë, pa këmbë, pa duar. Një trung njeriu, të cilit kalimtarët i shmangeshin gati me tmerr. Iu shmanga edhe unë. Kalova në anën tjetër të Lanës, ku pata një ndalesë pranë semaforit. Për sa kohë qëndrova aty, veshët më buçitën nga thirrjet e lypësit. Pastaj u ndez sinjali i gjelbër i

këmbësorëve, u rrëmbeva përsëri nga turma plot gjinj të zbuluar vajzash. Në fund të trotuarit të krahut të djathtë, përtej lokalit francez, te dyqani i shitjes së celularëve, qëndrova. Prej andej, zura të kontrolloja hyrjen në Sky Towns.

Më ishte ngulur ideja se bosin do të vinte i veshur si në mesditë, te zyra studio e doktorit, me kostumin blu. Nuk po shihja asnjë njeri me kostum blu apo të ndonjë ngjyre tjetër. Kjo më gozhdoi pranë dyqanit të celularëve. Prisja të më shfaqej një mashkull shtatlartë, veshur me kostum ngjyrë blu. Ndërsa ai kishte veshur një palë pantallona të çelëta, atlete dhe një bluzë me tri kopsa, të kuqe, në krahun e majtë të së cilës shquhej një lepurush. Kjo është arsyeja që unë mezi i rashë në të se tipi në fjalë ishte bosin. Po të mos përmend edhe një arsye tjetër. Përveçse me kostumin blu, unë prisja që ai të më shfaqej vetëm. I pashoqëruar, aq më pak nga një femër. Ai po më priste me një femër, bashkëshortja e tij. Së largu m'u duk brune, për shkak të lëkurës së nxirë nga dielli. Pas ca kohësh e nxira i iku, doli në pah një lëkurë e bardhë, në të zbehtë. Kishte një emër disi të veçantë: Dirina.

Vendimin për ta pranuar ofertën unë e mora pak minuta më vonë, në ashensor, tek ngjiteshim për në lokal. Në kabinë ndodheshim vetëm ne të tre, unë në një qoshe, ata të dy përballë meje. Për një çast më ngacmoi një

dyshim skandaloz: mos vallë kjo femër e bukur ishte kurthi për të më zënë brenda? Fytyra ime serioze u shfaq kalimthi në pasqyrën e ashensorit, pas krahëve të çiftit. “Meriton të ngordhësh si qene”, më tha. I dhashë të drejtë, isha qene.

2.

*T*ani që tregova rrethanat e punësimit tim nga bos, - më tej do ta quaj thjesht Nardi, - sqaroj motivin e vërtetë që më shtyu ta pranoja ofertën. Shkalla zero e zhvillimit tim mendor mund të ketë luajtur rol, por kjo s'ka lidhje me mua. Këtë mendim për mua e kanë të tjerët. Prandaj jam e detyruar të mbrohem në një mënyrë disi banale: nota mesatare me të cilën kam mbaruar shkollën e infermiereve, ka qenë tetë pikë tre. Po të shtoj se dikur pasioni im i vetëm ka qenë leximi, nuk besoj të futem në kategorinë e qenieve të shkallës zero të zhvillimit mendor. Megjithëse s'është në dorën time t'i bind të tjerët për të kundërtën.

Oferta më erdhi në një çast kotësie: përkundesha në krahët e një sëmundjeje që

tek unë shfaqet në formën e një dileme ciklike: ia vlente ta shtyja më tej? Është një sëmundje e vjetër imja, me zanafillë kohën kur lexoja shumë dhe e futa veten në kategorinë e vajzave të shëmtuara. Atëherë s'kisha përvojë, përveç pakënaqësisë që isha e shëmtuar. Kjo, kuptohet, nuk është përvojë. Dhe asgjë krahasuar me çastin kur, pasi ke mbledhur një lloj përvojë, zhgënjyese, arrin të përjetosh kotësinë tënde. S'ka të bëjë me shëmtinë, as me bukurinë. Është thjesht zhgënjim nga vetja. Versioni që shoqëron zakonisht vetëvrasjen e femrave shqiptare është gjendja e rëndë psikike, depressive. Nëse ndonjë ditë do të më shkrepë t'ia hip edhe unë taksisë për në botën tjetër, ka të ngjarë të thuhet, - duke supozuar që ky fakt të bjerë në sy, - se e bëra në kushtet e një gjendjeje të rëndë depressive. Se kam vuajtur tërë jetën nga depresioni për shkaqe të caktuara, të njohura ose të panjohura. S'do të isha edhe fort dakord. Mua më mundon kotësia e ekzistencës sime. Jashtë standardeve që pranohen zakonisht si normalitet. Do të më mundonte njëlloj edhe sikur mrekullisht të më krijoheshin kushtet t'i shtyja ditët në një nga vendet përrallore të botës, ku shkojnë miliardet. Dhe vedetat.

Në periudha të ndryshme, kotësinë time unë e mbush me kotësinë e të tjerëve. Kjo më krijon iluzionin e të qenit e nevojshme. Më motivon. Motivi më i fortë për mua u bë Monda, qysh se

vite të shkuara mbetëm në këtë botë fillikat. Me largimin e saj edhe ky motiv u fik. Zura të bija pre e kotësisë sime, të cilën nuk e mbushja më me kotësinë e të tjerëve. Një det pa anë e pa fund kotësie, ku notoja për inerci. Me rutinën e përditshme të pacientëve. Vuajtjen e fshehur nga buzët e Edës. Mëshirën për një kafshë pune të lodhur, të mbiquajtur Hipopotam. Oferta e dy meshkujve më erdhi në çastin kur kisha rënë sërish në krahët e sëmundjes sime të vjetër, të rrezikshme. Që më nxiste t'ia hipja një taksie për atje ku ndodhen prindërit e mi. Dhe dy vëllezërit. Në botën tjetër unë kam edhe dy vëllezër. Por kjo është një histori pa lidhje me vendimin për ta pranuar ose jo ofertën.

Intuita më tha ta pranoja. Kështu më këshilloi edhe fytyra ime serioze, kur Nardi dhe Dirina më përcollën në shtëpi me një BMW X5: “Mos u ngut t'ia hipësh asaj taksisë tënde”, më tha. Atë natë i kisha dhënë vetes të drejtën të pija verë. Ndihesha e dehur nga vera. Nga përkujdesjet e çiftit. Dhe nga rrezatimi turbullues i Dirinës, tek e cila bëja çmos t'i çoja sytë sa më pak.

Të nesërmen në mëngjes nuk u paraqita në pavijon. “Çdo gjë bëhet në marrëveshje me doktorin, më garantoj Nardi, mos e vrit mendjen.” Në orën nëntë, një zile në celular

më dha të kuptoja se tashmë ai priste poshtë, buzë Unazës. I hodha një vështrim të fundit në pasqyrën vertikale të korridorit fytyrës sime serioze. Ashtu si tek unë, edhe tek ajo s'kishte mbetur asnjë grimë nga euforia e mbrëmshme. Shkallët i zbrita me një shpresë: në ceremoninë e sotme të njohjes të ishte edhe Dirina. Kjo shpresë u zhgënjye sapo u gjenda poshtë. Në makinë po më priste vetëm Nardi. Me të njëjtin kostum blu të një dite më parë.

Zura vend në ndenjësën pranë tij. Ai u përpoq të sillej i përzemërt, më shtrëngoi dorën. Më pyeti si kisha fjetur. Nuk besoja që ai të ishte vërtet i shqetësuar se si kisha fjetur unë. Iu përgjigja “mirë” për forcë zakoni. M'u duk e tepërt ta pyesja nga ana ime për mirësjellje se si kishte fjetur ai. Ndoshta si çdo natë tjetër. Po ndoshta ndryshe, përderisa ndante shtratin me një femër si Dirina. E kjo kishte pirë shumë verë. Dhe, në fund të darkës, kur zumë të sodisnim nga lart Tiranën e zhytur në errësirë, dëshira për seks i lexohej qartë.

Unë s'kisha fjetur hiç mirë. Ushqimi i tepërt dhe vera bënë punën e tyre. Stomaku im nuk ishte mësuar të konsumonte në mbrëmje aq shumë ushqim, të shoqëruar me verë të kuqe. Në vështirësi për t'i tretur, stomaku im i pamësuar me gjëra të tepërta, më la pa gjumë. Nga kjo pagjumësi u çakërdis truri. Stomaku rrekej të përthithte ushqimin, truri përtypte e ripërtypte pikëpyetjen: Mos kisha bërë gabim?

Dhe tërë natën, e sulmuar nga fytyra e ndezur e Dirinës, isha përpëlitur nga njëri krah në tjetrin, duke përfytyruar më kot çiftin e pleqve, të aftë për të kryer vetëm nevojat vetjake: burri tetëdhjetë vjeç, gruaja shtatëdhjetë e pesë. Përveç moshës, gjatë darkës mësova edhe sëmundjet e tyre. Burri vuante nga hipertensioni, periodikisht, nga kapsllëku. Gruaja, përveçse nga tensioni, vuante nga osteoporozja. Me kriza të shpeshta dhimbjesh.

Pata një mëdyshje të fundit. T'i thosha punëdhënësit tim të sjellshëm se s'kisha fjetur hiç mirë. Pra, nuk isha në formë për t'u njohur me prindërit e tij. T'i lutesha të më linte edhe pak kohë të mendohesha. Atë çast, tringëlliu zilja e telefonit te mbajtësja e makinës. Ai e mori. "Po vijnë, u përgjigj, tani po nisemi." Dhe e vendosi përsëri atje ku e mori. "Po na presin, më tha, Dirina ka mbërritur para nesh."

Kërkesa për të më lënë edhe pak kohë të mendohesha, më mbeti në fyt. Ja ngaqë ai e nisi makinën, ja ngaqë ndryshe nga ç'kisha kujtuar, Dirina do të ndodhej e pranishme në takimin e njohjes.

Shtëpia ishte një vilë dykatëshe, ndërtuar midis ca pallateve të stilit të vjetër, me çati dhe mure tullash të kuqe, të pasuvatuar, në një lagje ku s'më kishte qëlluar të kaloja ndonjëherë. Nga të gjitha anët rrethohej me oborr, oborri me kangjell të lartë hekuri, ngjyer në të zezë. Në pjesën ballore, një rrugë e

asfaltuar rishtazi, e ndante nga pallati më i afërt. Në krahun e majtë, një rrugë, e më tej një lulishte, krijonin një hapësirë më të gjerë midis saj dhe vargut tjetër të pallateve. Prapa i rrinte një hotel i ri, i vogël, djathtas një pallat i vjetër dykatësh, nga i cili e ndante një rrip toke mbuluar me ferra.

Nardi e ndaloi makinën buzë trotuarit, pranë një makine tjetër. Një “Peugeot” ngjyrë gurëkali, e Dirinës, si mësova. Kjo po rrinte ulur në verandë, vetëm. Faktit që nuk m’u duk aq në formë sa një ditë më parë, nuk i dhashë rëndësi. E shpjgova me një natë të ngarkuar në krevat, pas gotave me verë të kuqe. Dhe nuk mund ta merrja me mend befasinë groteske që më priste. Disa minuta para se të mbërrinin ne, pleqtë ishin zënë me njëri-tjetrin dhe secili qe mbyllur në dhomën e vet. “Janë në gjendje lufte”, tha Dirina. Nuk e kuptova nëse këto fjalë, aty për aty pa domethënie për mua, ajo i shqiptoi me të tallur apo seriozisht. Nardi i mori seriozisht. Më kërkoi të falur, m’u lut të prisja pak në verandë, me Dirinën.

Zura vend pranë tryezës, në një karrige përballë saj. Dhe përfitova nga rasti t’i besoja konfidencën time të parë, domethënë natën e kaluar pa gjumë për shkak të ushqimit të tepërt dhe verës. Ajo më pohoi të njëjtën gjë. “Ti nuk pive shumë, vërejti, ndërsa unë e teprova.” Tek e shihja, më lindi një pyetje e paturpshme: sa herë duhej ta kishin bërë ata

deri ndaj të gdhirë? E trembur, i hoqa sytë prej fytyrës së saj, me një konstatim. “Kjo krijesë e lindur për seks, mendova, duhet të jetë të paktën nja pesëmbëdhjetë vjet më e re se i shoqi.” Atë çast, ky doli nga vila dhe unë ndjeva të skuqesha, të thuash se mendimin e kisha të shkruar në ballë. Ai nuk lexoi gjë. “Ejani, na u drejtua të dyjave, po na presin!” “Paqe?”, pyeti Dirina. Tjetri nuk u përgjigj. Duke u futur pas tij në sallonin e katit të poshtëm të vilës, unë nuk e dija se do të mbyllesha atje për plot katër vjet.

Në sallon gjendeshin disa dyer, të gjitha të mbyllura. Një abazhur në tavan, me drita të ndezura, mundësonte të shihje një numër pikturash mbi mure dhe një tryezë në mes, rrethuar me karrige shpinëlarta. Nga lart m’u duk sikur vinin tinguj pianoje. Nardi përpara, unë pas tij, Dirina pas meje, u gjendëm në një dhomë. Përballë, ulur në një kolltuk, po rrinte një grua. Kur u futëm ne, ajo nuk lëvizi. “Nëna ime”, tha Nardi. Gruaja më ftoi të ulesha. “Ia tregove shtëpinë?”, e pyeti Nardin. Ky iu përgjigj “jo”, do ta bënte sapo të mbaronim punë lart. Duke thënë kështu, ai shënoi me gisht nga tavani. Vetvetiu ngrita kokën, gjithnjë e pasigurt nëse prej andej vinin tinguj pianoje, apo më bënë veshët. Për të shuar dyshimin tim, gruaja sqaroi: “Im shoq është artist. Sa

herë i hipin xhindet, i zbrazet pianos. Kujton se i zbrazet. Është ngordhalaq, do ta shohësh!”.

Ajo u tall, dukej. E kujdesshme në veprimet e mia, unë nuk ia dhashë vetes të drejtën të shfaqja emocion. Atë që nuk e bëra unë, e bëri Dirina. “Babi është fantastik”, vërejti. Gruaja, autoritare, ia preu shkurt. “Budallenjve u duket interesant”, tha. S’duhej shumë për të kuptuar: nusja ishte në marrëdhënie të mira me të vjehrrin, por jo fort të mira me të vjehrrën. Sidoqoftë, arroganca e kësaj të fundit, nuk më pëlqeu. Në vend të Dirinës, fytyra ime serioze do të ishte përgjigjur. “Budallaqja më e madhe duhet të kesh qenë ti.” Mirëpo unë ndodhesha atje për tjetër gjë. Me një keqardhje për Dirinën, e cila e kyçi gojën, e pashë të udhës të mos i bindesha shpirtit intransigjent të fytyrës sime serioze. Ajo nuk e dinte rregullin elementar të infermieres: me pacientët tregohu e duruar!

Pacientja ime ishte shtatmesatare, e mbushur dhe në rini duhej të kishte qenë e bukur. E bukur ishte edhe tani. Me një fytyrë të bardhë, të pastër, sy të gjelbër, të qetë. Flokët e thinjur dikur duhej të kishin qenë më të dendur. Edhe trupi më i drejtë, më i fortë. Me kohë ai duhej të ishte shkurtuar, s’mund të them sa centimetra. Shoqëruar me një kërrusje, pothuaj deformim. Prita të më pyeste si më quanin. Nga vija, ku jetoja, me se merresha. Asgjë. Më tha se dhoma ime ndodhej

përballë dhomës së saj, në krahun tjetër të sallonit. Natën, në rast nevoje, do të komunikonte me mua me anë të një zileje, vendosur te koka e krevatit. Ky ishte një shtrat dopio, në faqen përbri dritares. Më tej vinte një komo e pajisur me një pasqyrë, dhe një dollap rrobash. Në anën e kundërt të kokës së krevatit, mbi një këmbalec, ishte vendosur një televizor. Susta e ziles ndodhej në një pozicion që edhe shtrirë, ajo mund ta mbërrinte duke zgjatur dorën. Sikundër, duke zgjatur dorën, mund të mbërrinte një komodinë, ku sytë më zunë një abazhur, pranë abazhurit një telekomandë. “Më dukeni mirë me shëndet, zonjë”, nxora më në fund fjalët e para. “Jo aq sa dukem”, tha ajo dhe shtoi: “Kur mendon të vendosesh këtu?”

Në të vërtetë, gatishmëria ime për t’u vendosur atje, nuk mjaftonte. Duhej marrë pëlqimi i të dy pleqve. Nëse ndonjërit prej tyre nuk ia mbushja syrin, marrëveshja prishej. Këtë lojë të doktorit dhe Nardit në kurrizin tim e mësova më vonë, por kur e mësova, s’më bëri përshtypje. Më duhej t’i pranoja rregullat e lojës. Kjo bënte pjesë në rregullat e lojës. Atë ditë të parë të njohjes, gruas duhet t’ia kem mbushur syrin. Përderisa pak ditë më vonë u vendosa në vilë, duhet t’ia kem mbushur edhe plakut.

Ky nuk na priti në dhomën e gjumit. E gjetëm në sallonin e katit të sipërm, identik me të poshtmin, me ndryshimin se në mes nuk kishte tryezë të rrethuar me karrige shpinëlarta, por piano. Një piano në ngjyrë të zezë, ku ai vazhdoi të luante pa e prishur terezinë edhe pas mbërritjes sonë. “Baba, i ndërhyri Nardi, kjo është Parashqevia.” “E shoh”, u përgjigj ai. Dhe vazhdoi të tijën. Ne zumë vend në ca karrige në anën e këndejeve të pianos. “Atje poshtë, foli befaz duke më mbërthyer me vështrim, me siguri të kanë thënë se unë jam artist, madje artist ngordhalaq me bojëra. Mos e mohoj!” Mbeta si e hipnotizuar. Ishte i thatë, fytyrëmprehtë, nevrastenik. Vështirë të besojë se mbi supet e rëna lehtazi mbante plot tetëdhjetë vjet. Fytyra ime serioze më sugjeroi t’i bëja ballë. “Artist po, iu përgjigja, me bojëra jo.” Fjalën “ngordhalaq” e hëngra.

Ai u ngrit në këmbë. “Të kanë gënjer, më tha. Profesionin im bazë është inxhinier minierash, me studime të kryera në Poloni në kohërat e qepës. Profesionin që kam ushtruar më gjatë, derisa dola në pension, është pedagog në Fakultetin e Inxhinierisë, jo profesor. Nuk e kam këtë titull dhe s’dua të vetëshpallem. Këto, për sqarim! Tani, dua të di, e keni të qartë zonjushë se ç’duhet të bëni në këtë vilë? Nëse po, përse pranuat?”

Fytyra ime serioze deshi të përgjigjej: “Sepse jam një qenie në shkallën zero të zhvillimit

mendor”. Ndërsa unë thashë: “Do të kem një rrogë mujore shumë të mirë, zotëri. Dhe shtova: Detyrën e kam të qartë”. “Jo, ma ktheu ai, nuk e ke të qartë. Atje poshtë presin e përcjellin gjysmën e Tiranës. Mbaje vath në vesh: këtu lart nuk do të lejosh të ngjitet askënd, mashkull apo femër, pa marrë pëlqimin tim... Edhe diçka të fundit: a ke dashnor? Punë për ty, veç t’i qërojmë hesapet. Do të ishte e papëlqyeshme ta sjellësh këtu, të flesh natën ose ditën. Jo për ndonjë gjë, por kjo është shtëpi, dhe shtëpia ka rregulla”.

“Baba, të lutem”, ndërhyri Nardi. “Njeriu i lajmëruar, gjysmë i shpëtuar”, ia ktheu plaku. E qetësova me një përgjigje evazive: do të zbatoja të gjitha rregullat. Me kaq mori fund edhe njohja. Ashtu si bashkëshortja, burri s’më bëri asnjë pyetje për hollësi të tjera të jetës sime.

U sulmova nga një valë e re dyshimi sapo ikëm nga plaku dhe zbritëm poshtë, te dhoma e gruas. E gjetëm atje ku e kishim lënë, ulur në kolltuk. Si një statujë të ngrirë. Nardi përfitoi të largohej. “Më duhet të paraqitem urgjentisht te zyrat e firmës”, tha. Do të isha larguar edhe unë. Shpresa e fundit për të shpëtuar. Kësaj radhe jo nga pleqtë. Ata nuk më ngjallnin frikë. Frikë po më ngjallte vetvetja.

Me kërkesën e vjehrrës autoritare, Dirina më tregoi mjediset e mbetura të vilës, që nga bodrumi, deri në tarracë. Në fillim dhomën ku

do të flija. Më e vogël se dhomat e pleqve, e pajisur me të gjitha orenditë e nevojshme. “Mund ta rregullosh sipas qejfit”, më tha. Pastaj më çoi në kuzhinë. Nga kuzhina, në banjë. Me këtë rast mësova një rregull të rreptë: kisha të drejtë të përdorja vetëm banjën e katit të poshtëm dhe kurrë, për asnjë arsye, atë të katit sipër.

Unë bëja sikur e dëgjoja. Tërë kohës, qysh se e pashë të na priste në verandë, kisha qenë e sunduar nga prania e saj. Si një skllave e magjepsur.

3.

*P*ara se të vendosesha në vilë, vajta në pavijon, të ndahesha me koleget. Hipopotami vuri me mua një bast: “Javën tjetër, më tha, do të kthehesh prapë. Marr përsipër të ta ruaj vendin deri javën tjetër”. Kjo më dha të kuptoja se, me gjithë supozimet për një vetëvrasje të mundshme të saj, Hipopotami s’do ta kishte pranuar atë që pranova unë.

Doktorin nuk e gjeta. Gjeta në paradhomë Eda-Sharon Stoun-in. Po shihej në një pasqyrë të vogël rrumbullake, lyente buzët me të kuq. “Doktori nuk është”, ma preu shkurt. Vura majat nga thembrat. Poshtë më priste Dirina.

I zbrita shkallët e pesë kateve me një frymë. Një ditë më parë, me porosi të Nardit, ajo më kishte ndihmuar të mbartja në vilë sendet e

mia më të domosdoshme. Tepër e ndjeshme tashmë, e nuhata, kjo lloj angarie nuk i pëlqeu, me të zënë vend në makinë, i kërkova të falur. Ajo më tha se s'kisha përse t'i kërkoja të falur. Gjatë rrugës deri në vilë nuk folëm. Ajo më shkarkoi buzë trotuarit dhe u largua pa u futur brenda.

Mbeta mbi trotuar, përballë vilës, e ndriçuar nga një mendim fatalist. Unë isha e përzgjedhur të kryeja një punë, që as Hipopotami s'do ta kishte pranuar. Isha pjesë e një loje, e paracaktuar në rolin tim ende pa ardhur në jetë. Doja, s'doja, për qeniet e kategorisë sime mbetëj vetëm ky rol kalimtar, në periferinë e ekzistencës. Dhe u futa në vilë me ndjesinë se po futesha në një botë tjetër.

Ekonominë e shtëpisë e mbante plaku. Po e quaj zoti Irfan, si ma përcaktoi protokollin. Çdo mbrëmje bëja listën e sendeve që duheshin blerë të nesërmen, ushqime, zarzavate, fruta. Herë pas here edhe sende të tjera: ilaçe për pastrimin e dysHEMEVE, të banjave, detergjente, letër higjienike, letër-peceta për tryezë. Në përputhje me kërkesat e mia, ai më jepte paratë. Unë isha e detyruar t'i paraqisja listën e shpenzimeve. Një herë në muaj shlyeja dritat, telefonin, ujin. Një herë në muaj më jepte para për blerjen e barnave. Ai merrte enalaprill, dy kokrra në ditë, njëzet

miligramëshe, izoptinë, tri kokrra në ditë, tetëdhjetë miligramëshe. Çdo mëngjes herët, esëll, gjysmë kokrre moduretik. Më jepte para edhe për barnat e gruas. Kjo merrte adalat dhe proponolol. Kohë më kohë ilaçe për zbutjen e dhimbjeve të osteoporozës. Kohë më kohë, gjithashtu, pinte çaj me lule basani për zorrën e trashë. Ajo vuante edhe nga zorra e trashë.

Dita ime e punës fillonte në mëngjes herët, pak a shumë në kohën kur zoti Irfan duhej të merrte esëll gjysmën e kokrrës së moduretikut, në orën gjashtë. Në verë zgjohesha edhe më herët, për të ndezur pompën e ujit. E vetmja mundësi për të kapur ujin që, pa pompë, në rastin më të mirë, ngjitej deri në katin përdhes. Kurse zoti Irfan, pas gjysmës së kokrrës së moduretikut, donte me çdo kusht të bënte banjë. Kur nuk vinte ujë as në mëngjes herët, e kjo ndodhte shpesh, atij i prishej humori. I ngriheshin nervat, nuk e mblidhte veten për tërë ditën. I prishej edhe oreksi. Këto ishin ditë të vështira për mua. Plaku bëhej grindavec dhe punët më shkonin së prapthi. Por ndodhte që në mëngjes herët, kur ndizja pompën, - kjo ishte vendosur në oborr, e siguruar nga çdo orvatje për ta vjedhur, - uji të vërshonte nëpër tuba me bollëk. Atëherë ngutesha t'i vija punët përpara. Në kohën që, në dhomën e tij, zoti Irfan ngrihej për të marrë moduretikun, unë ngjitesha në sallonin e katit sipër. Larjen e sallonit e kryeja përpara se plaku të shkonte

në banjë. Atje ai vonohej gjatë, por sado të vonohej, në orën shtatë, i përpiktë si sahat, ai më priste t'i çoja kafënë e mëngjesit. Në ditët e ftohta të dimrit, këtë ia shërbeja në dhomën e gjumit. Në ditët e ngrohta dhe në verë, në verandën e katit sipër. Edhe atje, ashtu si në verandën e katit poshtë, kishte një tryezë plastmase dhe një numër karrigesh po prej plastmase. Ndryshonte vetëm ngjyra. Poshtë ato ishin të bardha. Sipër, blu. Çka shprehte parapëlqimet e ndryshme të pleqve për ngjyrat.

Pasi i shërbeja kafënë zotit Irfan, ngutesha të pastroja banjën e tij. Ishte maniak, i sëmurë për pastrimin e banjës: e mbyllte me çelës dhe çelësin e mbante vetë. Atëherë zbrisja në kuzhinë, përgatisja një kafe për vete, derisa dëgjoja sinjalin e ziles elektronike. Kjo do të thoshte se duhej të shkoja në dhomën e gruas.

Quhej Firdus. E dija, e kisha lexuar, Firdus ishte emri i një poeti të vjetër persian. Ndeshja për herë të parë një njeri, për më tepër një grua, që quhej Firdus. Me të dëgjuar zilen elektronike, shkoja te dhoma e zonjës Firdus. Ajo nuk ma kërkoi si i shoqi t'i drejtohesha me "zonjë", por kur flas për të s'mund ta quaj ndryshe. E gjeja në shtrat, gjysmë të ngritur. Ose ulur në kolltukun ku rrinte fill si ngrihej nga shtrati.

Ajo nuk bënte banjë çdo mëngjes. E shumta një herë në javë. Ndodhte edhe më rrallë. Me kohë banja u kthye për të në torturë, por në

fillim ajo ishte në gjendje t'i kryente të gjitha veprimet, pa pasur nevojë për ndihmë. Pra, shkante në banjë me këmbët e veta. Për sa kohë qëndronte atje, unë merresha me dhomën. Hapja dritaren, rregulloja krevatin, merrja pluhurat, laja dyshemën. Kur ajo dilte prej andej, e pastruar dhe e krehur, i kisha dhënë fund edhe larjes së sallanit në katin përdhes. Për dyshemetë, zonjës Firdus i pëlqente të përdorja Lindo me aromë kivi dhe portokalli. Për banjat, po Lindo, me lëngun dhe etiketën ngjyrë blu. Unë kujdesesha të gjeja gjithmonë këto lloje Lindoje, me aromë kivi dhe portokalli për dyshemetë, me lëng dhe etiketë ngjyrë blu, për banjat.

Kafenë nuk e pinte. Nuk e kishte pirë gjithë jetën. Duke qenë kështu, kur kthehej në dhomë, e pyesja ç'dëshironte t'i përgatisja për mëngjes. Pas kësaj pyetjeje ndodhte t'i ngriheshin nervat kot më kot. Nuk përmbahej, shfrynte me një arrogancë që më irritonte. "Një dash të pjekur dua, më thoshte, ma bën një dash të pjekur?" Këto shpërthime më krijonin stres. Mirëpo unë kisha kaluar nëpër duart e Hipopotamit. Gjeja diçka të përbashkët midis zonjës Firdus dhe Hipopotamit. Dhe marr guximin të shpreh një mendim të fshehur. Femrat shqiptare, të bukura a të shëmtuara, të reja apo plaka, orvaten ose jo të vetëvriten me një nga mënyrat e njohura, janë kafshë të lodhura. Këtë mund ta shohësh në mëngjes,

kur zgjohen nga gjumi. E kam nga përvoja. Fytyrat e tyre, kur zgjohen në mëngjes nga gjumi, të bëjnë për të qarë. Më bënte për të qarë edhe fytyra ende e bukur e zonjës Firdus.

U mësova me shpërthimet e saj, si isha mësuar me shkelmat e Hipopotamit. Kur ajo shfrynte për desh të pjekur, e kuptoja, humori i saj që në pikën zero. Më e pakta, s'duhej të kishte fjetur mirë. Pa e zgjatur, shkoja në kuzhinë. Atje i përgatisja mëngjesin e zakonshëm të ditëve me humor në pikën zero: gjalpë, reçel, një gotë çaj dhe bukë të thekur. Ia shërbeja në tryezën që ndodhej në mes të sallonit. Në ditët me humor më të ngritur, ajo nuk shfrynte për desh të pjekur. Më thoshte, për shembull: sikur të më bëje një omëletë, pak djathë kaçkavall të pjekur, të më zieje një kremviçë? Këto lloj ushqimesh nuk i bënë mirë, megjithatë ia plotësoja nepset. Zonja Firdus ishte një fëmijë plot me nepse të vogla.

Gjatë kohës që ajo hante mëngjesin, në periudhat me paqe, në sallonin e katit përdhes zbriste edhe zoti Irfan. Ky ishte çasti kur ata vendosnin ç'duhej t'u përgatisja për drekë. Pasi binin dakord, ai nxirrte një portofol dhe më jepte të holla për pazaret e ditës. Unë i merrja, i fusja në xhepin e përparësës. Në vilë rrija e veshur me përparëse. Jo të bardhë, si në spital. Ngjyrë vishnje, zgjedhur sipas shijeve të plakut, e kjo më bënte të dukeshja më shumë si kameriere ose pastruese hoteli.

Në periudhat me gjendje lufte plaku nuk zbriste. Ai dërgonte sinjalin e tij të ziles elektrike dhe unë ngjitesha tek ai, për paratë e shpenzimeve të ditës dhe me propozimin për menynë e drekës. Gjendjet e luftës, kur rrinin pa folur dhe pa u takuar, - vetvetiu ndërprisnin edhe ndonjë shëtitje bashkërisht, deri te një lulishte, në një shesh nja treqind metra larg vilës, - plasnin për arsye që unë nuk i merrja vesh. Këto ishin periudhat më të vështira për mua. Të dy bëheshin tekanjozë, nuk i hapnin rrugë njëri-tjetrit as për menynë e drekës apo të darkës, dhe isha e detyruar t'u shërbeja veç e veç, njërit lart, tjetrit poshtë. Me kohë ua mora dorën, zura të gatujaja të njëjtën meny për të dy, si të më mbushej mendja. Ua mësova edhe shijet, edhe huqet, ç'u bënte mirë e ç'u bënte keq. Ndryshoja gjëra të vogla, fjala vjen, në pjatën e zotit Irfan nuk vendosja kastravecë, as djathë kaçkavall ose djathë të bardhë të kripur. Kastravecët ai nuk i honepste, djathi kaçkavall, thoshte, i bënte dëm për tensionin, po ashtu dhe djathi i bardhë, i kripur. Këtë të fundit ia përgatisja veç, ia vendosja më parë në një enë me ujë për t'i hequr kripën. Supën dhe pjatën kryesore ia shërbeja gjithashtu me pak kripë dhe, doemos, me pak yndyrë.

Zonja Firdus nuk ia varte regjimit ushqimor, i përdorte të gjitha. Gjendja e saj shëndetësore ishte shumë më problematike se e të shoqit, por ajo nuk e çante kokën. Po të mos e detyroja

unë, as barnat nuk do t'i merrte rregullisht. Ndryshe nga i shoqi, që u bindej mjekëve, i ndiqte me përpikëri porositë e tyre, zonja Firdus nuk i çmonte edhe aq. “Po t'i dëgjosh ata, më tha një ditë, më mirë shko e hape gropën me duart e tua.”

Kohëzgjatja e periudhave me gjendje luftime ishte e paparashikueshme. Ndodhte të rrinin pa u parë dhe pa folur edhe dy javë. Gjatë kësaj kohe, si të donte t'i ngrinte moralin vetes, zoti Irfan luante në piano në mënyrë demonstrative. Lodhej shpejt dhe dëgjoja armiken e tij të thoshte: “Ja ngordhalaqi, zuri të na çajë kokën”. Pakënaqësinë e tij plaku e shprehte më shumë duke u larguar nga shtëpia, në formë arratie. Këto s'ishin gjë tjetër veç ca vërdallosje aty rrotull, e shumta deri te sheshi ku ulej në ndonjë stol, pa iu bashkuar grupit të pensionistëve të lagjes, që vrisnin kohën me letra ose domino. “Edhe nëse më hipën të leh, më tha një ditë, dua të leh vetëm, jo në tufë.” Pastaj nisnin tratativat e pajtimit, kur plaku i ndërpriste arratitë, nuk luante as në piano dhe në katin sipër mbretëronte qetësia. Askush nga rrethi familjar nuk ndërhynte, ata ishin mësuar me gjendjet e luftës midis pleqve. Ndërsa unë vetëm ndërmjetësoja për shkëmbim mesazhesh. Ndonjë mëngjes, njëri nga pleqtë më pyeste për shëndetin e tjetrit. Kjo mjaftonte për të kuptuar ç'duhej të bëja: ia transmetoja partnerit dhe ktheja përgjigjen: keq, ose mirë. Keq do të

thoshte se gjendja e luftës vazhdonte. Mirë nënkuptonte gatishmërinë për pajtim. Vetëm gatishmërinë!

Pajtimi vinte më vonë, pas një lloj rituali: një shkëmbimi letrash. Atëherë i rashë në të përse, ndër shërbimet e para, plaku më kishte kërkuar të blija një sasi të konsiderueshme zarfesh. Prita më kot të më jepte ndonjë letër ta çoja në postë. Ai nuk dërgonte letra. As merrte. Edhe zonja Firdus nuk dërgonte letra. As merrte. Ata jepnin e merrnin letra vetëm me njëri-tjetrin, në periudhat e gjendjes me luftë.

Zakonisht, akullin e thyente plaku. Një mëngjes, kur i shërbeja kafënë, ai më jepte zarfin. Të mbyllur. Letrën duhej ta kishte përgatitur një natë më parë. Mbi zarf, me shkrim të bukur, shënohej: “Zonjës sime Firdus, këtu poshtë”. Unë ia dorëzoja marrëses pasi kishte ngrënë mëngjesin. Përgjigjja vonohej në varësi të humorit të saj. Ndodhte të vinte shpejt, brenda ditës. Ndodhte të vonohej edhe dy-tri ditë. Por kurrë nuk mungonte. Ndonjë mbrëmje ajo më thërriste në dhomën e saj, më dorëzonte zarfin. Gjithashtu të mbyllur. Sipër, me një shkrim jo aq të bukur sa të bashkëshortit, shkruhej: “Zotërisë tim Irfan, atje lart”. Unë ngjitesha në çast, ia dorëzoja marrësit dhe largohesha. Ky, nga ana e tij, përgjigjej që të nesërmen në mëngjes.

Tundimi im më i madh, për sa kohë qëndrova në vilë, ka qenë të mësoja përmbajtjen e

letërkëmbimit. Zarfet e plakut ishin gjithmonë të plotë, të rëndë. Kuptohej, ai shkruante gjatë. Letrat e zonjës Firdus, përkundrazi, duhej të ishin të shkurtra, shumë të shkurtra. Dyshoja se zarfet e saj ktheheshin bosh, aq të lehta ishin. Shpesh nuk e frenoja kureshtjen për të mësuar se çfarë i shkruanin njëri-tjetrit ata dy pleq. Çasti më i përshtatshëm për të shtënë në dorë ndonjë letër ishte mëngjesi, kur zoti Irfan mbyllej në banjë gjatë, dhe pak më vonë, kur edhe zonja Firdus mbyllej në banjë, po aq gjatë. Pa sukses! Në sirtarët e komodinave të tyre gjeja zarfe, letër të bardhë, stilolapsa, sende të tjera të secilit, por kurrë zarfe me letër brenda. Një herë kujtova se pata fat, në komodinën e zonjës Firdus gjeta një zarf me shënimin: “Zonjës sime Firdus, etj.”. U gëzova kot, zarfi qe bosh. Pleqtë nuk më dhanë asnjë mundësi. Letrat zhdukeshin s’di se ku dhe s’di se si, pa lënë gjurmë. Mendoja se gjendjet e luftës ata i provokonin qëllimisht, për të nisur letërkëmbimin. Një lojë e pleqve, ndoshta për t’i thënë njëri-tjetrit gjëra të pathëna. Një fantaksje! Një trill pleqërie!

Në fund të periudhave me luftë, si shkëmbenin disa letra, loja ndërpritej. Zoti Irfan, një mëngjes, më kërkonte t’i bëja të ditur zonjës Firdus se do të drekonte me ne, në tryezën e sallonit të katit përdhes. Merrej vesh,

kishin rënë dakord për vendosjen e paqes. Dilja të bëja pazaret. Ata të dy i lija herë në verandën e katit të sipërm, herë në atë të katit të poshtëm. Kur kthehesha, i gjeja atje ku i kisha lënë, duke vështruar makinat dhe kalimtarët. Në një pozë të ngrirë. Si në ato fotografitë e dikurshme bardhezi të mesit të shekullit XIX. Në pritje të shihnin ndonjë makinë të njohur, e kjo të ndalonte përpara vilës. E prej andej të zbrisnin personat, në pritje të të cilëve rrinin.

Vizitorja më e rregullt ishte vajza e çiftit. Kjo qe një grua rreth të pesëdhjetave, me profesion gjyqtare. E quanin Afërdita. E vetmja që nuk mungonte të vinte te pleqtë edhe në periudhat me luftë. Nëse ata ndodheshin në një nga verandat, ajo këmbëngulte të futeshin brenda. Në gjendjet me luftë, në fillim ndalonte te dhoma e zonjës Firdus. Unë ngutesha t'i bëja një kafe. Kur futesha në dhomë me kafënë, ajo e ndërpriste bisedën. Pra, duhej t'i lija vetëm.

Gjyqtarja Afërdita nuk u mësua kurrë me praninë time në vilë. Duket, fytyra ime, sado serioze, nuk i pëlqente. Kjo është një hamendje. Fytyra ime mund të mos luante ndonjë rol dhe në kendarin e antipatisë ndaj meje të zonjës gjyqtare, të peshonin hollësi të tjera, të cilat duhej t'i dinte. Por meqë fytyra ime serioze, që nuk mungon të më shfryjë sa herë i teket fjalën “shëmtirë”, është armikja ime më e madhe, fajin dua t'ia vë asaj. Megjithatë, këtu ka diçka kontradiktore. Dua